



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT**

04NR. 351-8314 /2020

Klinë, 06.03.2020

**KONTRATA NR. 01-DKA/2020**

KOMUNA KLINË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, nenit 19, Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar, pika 4, kontrata me vlerë minimale, që përfaqësohet nga drejtori i institucionit arsimor, z. Xhevdet Bashota, në njërën anë;

Dhe

"VËLLEZËRIT HOTI" SH.P.K. (në vazhdim "Furnizuesi"), me adresë - KLINË NR. BISNESIT 810136540 të cilën e përfaqëson Faik Hoti, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

**"RENOVIMI I KULMEVE NË SHKOLLA SI PASOJË E ERËRAVE TË FORTA" me numër identifikues: 634-20-010-247**

**Neni 1**

**Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë FURNIZIM – "RENOVIMI I KULMEVE NË SHKOLLA SI PASOJË E ERËRAVE TË FORTA" nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

| NO                                | PËRSHKRIMI I POZICIONIT                                                                                                | Njësia | Sasia | Çmimi | Totali |
|-----------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|--------|
| SHFMU "Dëshmorët e Kombit", Çabiq |                                                                                                                        |        |       |       |        |
| 1                                 | Furnizimi dhe montimi i llamarines se plastifikuar (Mbulesa e Kulmit)                                                  | m2     | 30    | 12.00 | 360.00 |
| 2                                 | Furnizimi dhe montimi i llamarines se plastifikuar (Mbulesa e Kulmit) mrapa oxhakut më gjërësi 75cm.                   | m'     | 4     | 8.00  | 32.00  |
| 3                                 | Riparimi i kulmit në teresi si dhe forcimi i kulmit më vida bulona elemente tjera.                                     | copë   | 300   | 1.20  | 360.00 |
| GJITHSEJ                          |                                                                                                                        |        |       |       | 752.00 |
| SHFMU "Avni Zhabota", Shtupel     |                                                                                                                        |        |       |       |        |
| 1                                 | Riparimi i dhe montimi (përforcimi) me vida adekuate për lidhjen e llamarines në disa vende shkolle në Fshatin Shtupel | copë   | 1     | 1.68  | 168.00 |
| GJITHSEJ                          |                                                                                                                        |        |       |       | 168.00 |
| SHUMA NE TOTAL                    |                                                                                                                        |        |       |       | 920.00 |

1.2. Sipas karakteristikave të dhëna në ofertën financiare të bashkëngjitur në këtë kontratë

## **Neni 2**

### **Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë– 2 DY DITË nga koha e nënshkrimit të kontratës .

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë NE VENDET E CAKTUARA NGA ORGANIZATORI – Klinikë

**2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetët DDP –KLINË.**

## **Neni 3**

### **Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

## **Neni 4**

### **Çmimi**

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **920.00 €.**

**DDP** ( të gjitha të përfshira në çmim ( dogana, taksa lineare dhe TVSH)

(NËNTËQIND E NJËZET EURO).

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 .Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.Pagesa do te behet siq vijon: **Me të pranuar të Paisjeve me faturë dhe Fletëdorëzim- fletëpranim .**

## **Neni 5**

### **Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paçartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

**Menagjimin e kontratës në bazë të Nenit 81 të LPP 05/L-068 do ta bëjë**

**DREJTORI I SHKOLLËS - Z. XHEVDET BASHOTA**

| Për Furnizuesin<br>"VËLLEZËRIT HOTI", SH.P.K |                    | Për Autoritetin Kontraktues<br>SHFMU "DËSHMORËT E KOMBIT", ÇABIQ |                    |
|----------------------------------------------|--------------------|------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Emri:                                        | FAIK HOTI          | Emri:                                                            | XHEVDET BASHOTA    |
| Pozita:                                      | DREJTOR            | Pozita:                                                          | DREJTOR            |
| Nënshkrimi:                                  | <i>[Signature]</i> | Nënshkrimi:                                                      | <i>[Signature]</i> |
| Data:                                        | 05.03.2020         | Data:                                                            |                    |
| Vula:                                        |                    | Vula:                                                            |                    |

